



Raport vjetor 2024

QENDRA RINORE ARDHMËRIA– KLINË

KOSOVË

1 Janar & 31 Dhjetor 2024

PERGADITUR NGA: VITORE ZEFI

ME 31/12/2024

KLINË



Hyrje:

Qendra Rinore Ardhmeria-Klinë është themeluar në vitin 1999, që prej këtij viti qendra organizon aktivitete për të rinjë dhe gjithashtu edhe këtë vit janë zhvilluar programet dhe iniciativat rinore. Në këtë raport janë të përmbledhura të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara në Qender Rinore Ardhmeria-Klinë gjatë vitit kalendarik 2024.

Aktivitetet e qendrës rinore Ardhmeria-Klinë të cilat janë zhvilluar dhe janë të vazhdueshme:

1. AKTIVITETET DHE INICIATIVAT RINORE

2. BASHKËPUNIMET & PARTNERITET

3. PROJEKTET

4. STATISTIKAT /PËRFITUESIT

1. AKTIVITETET & INICIATIVAT RINORE:

1.1 SESSIONE INFORMUESE

Janë realizuar kater sesione informuese për Vullnetarizmin. Sesionet informuese kishin për qëllim për të ngritur njohuritë për punën vullnetare, për një jetë aktive në shoqëri, përgaditje për jetë dhe punë në nivel më të gjerë bashkëkohor. Sesionet janë zhvilluar me nxënësit e shkolles profesionale "Fehmi Agani " në Klinë, dhe nga keto sesione kanë përfituar 83 të rinjë të Komunës së Klinës.



Zhvilluar me 8&9 Shkurt 2024

1.2 DITA E PAVARSISË SË KOSOVES

Grupi rinor “Klina Youth Chapter”, në kuader të Qendres Rinore Ardhmëria Klinë organizon një hulumtim/Intervista për të rinjë dhe qytetar, që të japin mendimet e tyre e lidhur me situatën e tanishme: “Çfarë duhet të ofroj Kosova, që të Rinjtë mos ta braktisin vendin e tyre” Shumë qytetar dhanë kontributin e tyre në këtë Iniciativ. Të dalurat nga intervista janë studijuar dhe analizuar nga grupi i të rinjve dhe këto rezultate janë shfaqur publikisht në një program të Radio Albes në Klinë. Për të folur për këtë initiative rinore, në studio moren pjesë vullnetarët, Rinor Berisha, Floresita Berisha dhe Gresa Agushi.

Zhvilluar me 17 Shkurt 2024



1.3 TRAJNIM- ZHVILLIMI I AFTËSIVE TË BUTA DHE DEGJIMI AKTIV

Është zhvilluar trajnimi me temën “Zhvillimi i aftësive të buta dhe degjimi aktiv” tek të rinjtë. Trajnimi u mbajt në Qendrën Rinore “Ardhmeria-Klinë” dhe nga ky trajnim kanë përfituar 16 të rinjë, me të cilët trajtuam temën se si ti përdorim aftësitë e buta dhe si të jemi dëgjues aktiv. Për ta bërë atraktive trajnimin u realizuan lojëra të ndryshme me fokus praktikimin e aftësive të buta dhe dëgjimin aktiv.

Zhvilluar me 26 Shkurt 2024


1.4 T R A J N I M



M- PËRGADITJA E NJË PROJEKT PROPOZIMI

Është realizuar trajnimi me temën “Përgaditja e një projekt propozimi” për të rinjtë. Trajnimi u mbajt në Qendrën Rinore “Ardhmeria-Klinë” dhe nga ky trajnim kanë përfituar 16 të rinjë, me të cilët trajtuam temën se si të përgaditim një projekt propozim dhe cilat janë pikat kryesore që duhet të përfshihen kur shkruhet një projekt propozim. Për ta bërë atraktive trajnimin u realizuan lojëra dhe aktivitete të ndryshme me qëllim praktikimin e realizimit të projekt propozimit.

Zhvilluar me 27 Shkurt 2024



1.5 SESION ORIENTUES

Kemi realizuar sesionin orientues me temën “Si të aplikojmë në programe ndërkombëtare”. Sesioni është zhvilluar në Qendra Rinore Ardhmeria Klinë, dhe nga ky sesion përfituan të rinjë të moshës 15-24 vjeq me të cilët u informuan për programin Evropian-ESC, si të përgadisim një CV dhe një letër Motivuese dhe si të aplikojmë në kampe Evropiane.

Zhvilluar me 28 Shkurt 2024

1.6 LIGJERATË VETËDIJËSUESE- PARANDALIMI I DUKURIVE NEGATIVE

Realizuar ligjeratën vetëdijesuese me temën “Parandalimi i dukurive negative” Për të rinjtë e shkollës fillore “Ismet Raci” dhe shkollës fillore “Motrat Qiriazi”.

Ligjerata u mbajt në Qendra Rinore “Ardhmëria- Klinë “. Të rinjtë mësuam për pasojat e dukurive negative në shoqërinë tonë siq janë konsumimi i duhanit, alkoolit dhe drogës, dhe pasojat që sjellin këto dukuri negative në shoqërinë tonë. Të rinjtë donin të dinin më shumë rreth këtyre dukurive dhe krijuam hapsirë për pyetje dhe diskutime të ndryshme rreth kësaj teme. Për ta bërë më atraktive mjedisin u zhvilluan gjithashtu edhe lojëra argetuese për të rinjtë.



Zhv
illu
ar
me
12
Ma
rs
2024

1.7 SESION INFORMUES-AMERICAN ADVISING CENTER

Është për t'u lavdëruar që Qendra Amerikane e Këshillimit po ofron mbështetje për të rinjtë kosovarë në arritjen e qëllimeve të tyre arsimore. Iniciativa të tilla si e sotmja në Qender Rinore në Klinë mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në jetën individuale dhe të kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të. Sesionet e informacionit si këto mund të ofrojnë udhëzime dhe burime thelbësore për studentët që po lundrojnë në procesin e aplikimit, veçanërisht kur përfshihen bursa në universitetet amerikane.



1.8 LIGJERATË VETËDIJËSUESE-JETA E SHËNDETSHME

Zhvilluam ligjeratën vetëdijësuese me temën “Jeta e shëndetshme” për të rinjtë e shkollës fillore “Ismet Raci” dhe shkollës fillore “Motrat Qiriazi”. Ligjerata u mbajt në Qendra Rinore “Ardhmëria-Klinë”. Të rinjtë mësuan se qfarë është jeta e shëndetshme, rëndësia e saj dhe cilët janë hapat që duhet ndjekur që të zotërojmë një jetë të tillë. Të rinjtë ishin kurioz të dinin më shumë rreth temës dhe krijuam hapsirë për pyetje dhe diskutime të ndryshme rreth temës. Për ta bërë më atraktive ligjërimin u zhvilluan gjithashtu edhe lojëra argetuese për të rinjtë.



Zhvilluar me 19 Mars 2024

1.9 KURSE TË GJUHES ANGLEZE-

Në menyrë të rregullt ditore është organizuar kursi i gjuhës Angleze për fëmijë dhe të rinjë. Çdo ditë gjatë vitit këtij viti kanë përfituar shumë pjesëmarrës të cilët kanë ndjekur kursin e Gjuhës Angleze pa pagesë. Kurset e gjuhës Angleze gjatë vitit 2024 janë udhëhequr nga vullnetari I korpusit të Paqes Joe Matragrano (PCV). Kursi i Gjuhës Angleze është zhvilluar 2 orë ne javë për secilin grup (3 grupe) dhe ka zgjatur 7 muaj.



Zhvilluar nga Marsi-Tetor 2024.

1.10 PROMOVIMI I VULLNETARIZIMIT


Vullnetarët e Qendra Rinore Ardhmëria shpërndanë broshura promovuese për vullnetarizmin në komunën e Klinës. Qendra kohë pas kohe organizon fushata të ndryshme rreth vullnetarizmit, përparësitë që i fiton një vullnetar dhe me shpërndarjen e këtyre broshurave ne synuam të i informojmë edhe të tjerët që të jenë të gatshëm që të regjistrohen si vullnetar.



Zhvilluar me 15 Prill 2024

1.11 NGJARJE KULTURORE- PROMOVIMI I BIODIVERSITETIT KULTUROR

Promovim i biodeversitetit kulturor/ Vizitë e të rinjve Ujvara e Mirushës, Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë realizoi një vizitë për të rinjtë e Klinës tek Ujavara e Mirushes, dhe kësaj vizite iu bashkuan edhe dy vullnetar të Korpusit të Paqes si dhe dy akter të ish ekipit "Up to Youth". Qëllimi kryesor i vizites ishte promovimi i biodeversitetit kulturor dhe ndërgjegjësimi i të rinjeve për vlerat, ekosistemet dhe burimet e zones natyrore, rëndësinë e menaxhimit dhe përdorimit të burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme.



Zhvilluar me 5 Maj2024

1.12 NGJARJE KULTURORE-DITA E FËMIJËVE

Dita e fëmijëve shënohet me 1 Qershor në mbarë botën. Fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë, që në këtë ditë të ndihen të lumtur dhe të festojnë me prindërit dhe bashkëmoshatarët e tyre. Edhe në qytetin tonë të Klinës vullnetarët e qendres rinore Ardhmëria-Klinë shënuan ditën e 1 Qershorit me shumë lojera kreative për fëmijë në parkun e qytetit "Ilir Merturi" në Klinë.

Me 1 Qershor fëmijët kanë ditën e tyre të festës, dhe të rinjtë zhvilluan aktivitetet e larmishme për ta bërë këtë ditë sa më të bukur për të vegjëlit. Në këtë aktivitet moren pjesë një numër i madh fëmijësh, ku shihej një gezim dhe një buzëqeshje në fytyrat e secilit fëmijë. Ky aktivitet është realizuar në bashkëpunim me mësuesit Vlora Bacaj dhe Mustafë Delija (sh.f. Motrat qiriazhi) dhe nxënësit e tyre, falenderojm shumë mësuesit për pjesëmarrje në aktivitetet tona si dhe të gjithë prindërit e fëmijëve.



Zhvilluar me 1 Qershor 2024

1.13 VIZITË ZYRTARE NGA WASHINGTON DC

Të premten, patëm kënaqësinë të presim drejtoreshën e Korpusit të Paqes, Carol Spahn, si dhe stafin e Korpusit të Paqes në Kosovë për një prezantim mbi qëndrueshmërinë dhe iniciativat e gjelbra. Të rinjtë tanë mësuan për sistemet e mbeturinave zero dhe stuhi mendimesh për strategjitë për menaxhimin e mbeturinave në komunën tonë.

Faleminderit Carol Spahn dhe [Peace Corps Kosovo](#) për vizitën dhe për prezantimin e mrekullueshëm nga të rinjtë e qytetit tonë!



**1.
1
4
P
R
O**

GRAM VEROR

Kampi veror është realizuar gjatë muajve të verës në qender rinore si dhe në Parkun e qytetit. Stafi i Qendrës dhe Trajnerët kanë realizuar 5 mbledhje trajnuese/informative për vullnetarët. Takimet trajnuese u realizuan për përgatitjen e Kampit veror me fëmijë. Qëllimi i këtij programi është që të motivojm të rinjtë të punojn me fëmijë dhe njëkohësisht të zhvillojnë aftësitë dhe kapacitetet rinore në organizim, menaxhim dhe lidërsip. Pas informimit të vullnetarëve, trajnimit të tyre dhe përcaktimit të agjendes dhe kalendarit për Kamp Veror I cili është zhvilluar gjatë muajit korrik dhe ka zgjatur 14 ditë gjatë këtyre ditëve të ngrohta korriku çdo ditë kemi ofruar ëorkshope për 30 fëmijë, lojra edukative dhe argetuese, ushtrime teatrale,



Zhvilluar prej 14-26 Korrik 2024.

1.15 NGJARJE KULTURORE- FESTE PËRSHENDETESE

Perdersona vullnetari ynë i mrekullueshëm Zach Bernkoph dhe Joe Matragrano përfunduan kohën e tyre në komunitet, organizuam një festë përshendetese të përzemërt. Festimi i kohës së vullnetarizimit të tyre tregon se sa shumë u vlerësuan për punën që zhvilluan në organizatën tonë dhe krijuan një lidhje me vendin dhe komunitetin tonë. Është e mahnitshme se si marrëdhëniet e ndërtuara gjatë këtyre viteve mund të krijojnë një ndikim kaq të qëndrueshëm, si për vullnetaret ashtu edhe për komunitetin. Faleminderit Zach dhe Joe për gjithë punën dhe kontributin e te gjithë vullnetareve të korpusit të paqës në Kosovë.

Zhvilluar me 28 tetor 2024



1.16 NGJARJE KULTURORE-HALLOWEEN

Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë organizoi eventin kulturor “Halloween” për fëmijë dhe të rinjë. Halloween është një festë që festohet çdo vit më 31 Tetor.

Gjatë aktivitetit vullnetarët nga Qendra Rinore punuan me një grup fëmijësh, të rinjtë krijuan dhe drejtuan aktivitete duke filluar nga vizatimi i fytyrës, puntori edukative, lojra shpërblyese dhe vallëzim. Fëmijët u kënaqën gjatë aktivitetit për dy orë dhe në fund reflektuan mbi ecurin e aktivitetit ku fëmijët paten mundësi të shprehin kënaqesitë dhe pakënaqesitë e këtij eventi. Më pas, vullnetarët reflektuan se çfarë shkoi mirë dhe çfarë do të bënin ndryshe për aktivitetin vitin e ardhshëm. Urime festa Halloëeen! 🎃



Zhvilluar me 31 Tetor 2024

1.17 WORKSHOP EDUKATIV

20 Nëntori-Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve është kthyer jo vetëm në një ditë festive, por edhe në një ditë për ti thënë jo dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Është dita kur vetë fëmijët shprehen lirshëm për të thënë të drejtat e tyre. Për të shënuar këtë ditë të veçantë kemi organizuar punëtori edukative për fëmijë në mënyrë që të shprehen lirshëm për të thënë të drejtat e tyre dhe të kalojnë një ditë kreative së bashku me Vullnetarët e Grupit Rinor “Klina Youth Chapter”.

Aktiviteti është mundësuar nga të rinjtë në bashkëpunim me shkollën fillore “Motrat Qiriazhi” në Klinë, si dhe në kordinim me dy mësuesit e klases së IV’të.

Zhvilluar me 20 Nëntor 2024



1.18 SHITJA E KARTOLINAVE & EMBËLSIRAVE

Të rinjtë nga Qendra Rinore Ardhmeria-Klinë zhvilluan disa puntori dhe punuan shumë ditë që të përgadisnin kartolina për shtije, të gjitha kartolinat janë punuar me kujdes që të shiten kartolinat së bashku me embëlsira për Krishtlindje në qendër të qytetit për 1 Euro!. Të gjitha fondet e fituara synohen që të shkojnë për bamirësi.



Z
h
v
i
l
l
u
a
r
m
e
1

2 -20 Dhjetor 2024.

1.19 TRAJNIM PËR TË RINJË

1 Dhjetor-Dita ndërkombetare Hiv/Aids, shenuam ditën ndërkombetare të Hiv/Aids me një trajnim vetëdijësues për të rinjtë e moshave të reja. Ky trajnim është udhëhequr nga dy vullnetare të cilat për herë të parë kishin mundësi zhvillojnë aftësitë e tyre për udhëheqjen e një trajnimi edukativ, gjithashtu pjesëmarrësit ishin shumë të interesuar dhe aktiv për temën e HIV/AIDS.



të

Zhvilluar me 1 Dhjetor 2024.

1.20 TRAJNIM PËR TË RINJË

Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit, e cila shënohet çdo vit më 5 dhjetor, është një ditë e veçantë për të promovuar dhe festuar rolin e vullnetarëve në ndihmën e komunitetit dhe zhvillimin shoqëror.

Kjo ditë ofron një mundësi për të falënderuar të gjithë ata që japin kohën, energjinë dhe aftësitë e tyre për të ndihmuar të tjerët dhe për të nxitur vlerat e solidaritetit dhe humanizmit. Po ashtu, është një thirrje për të inkurajuar më shumë njerëz të angazhohen në aktivitete vullnetare.

Vullnetaret e Qendres Rinore” Ardhmeria-Klinë” organizuan trajnim për të rinjtë me qëllim promovimin dhe inkurajimin e gjeneratave të reja për vullnetarizem.



Zhvilluar me 5 Dhjetor 2024.

1.21 INICIATIVA HUMANITARE 🌲

Puna vullnetare në Qendra Rinore Ardhmeria Klinë solli një punë intensive të të gjithë vullnetarëve aktiv gjatë muajit Dhjetor 2024, në përgatitjen dhe dekorimin e kartolinave dhe për urime festive të Krishtlindjes dhe Vitit të Ri.

Pas përgatitjes së kartolinave, vullnetarët u angazhuan në përgatitjen e pakove humanitare 📦 në sheshin kryesor të Klinës për shitjen e këtyre materialeve si kartolina dhe embëlsira... fondet e të cilave ishin të destinuara për blerjen e pakove për familje. Fondit për bamirësi ju kanë bashkangjitur edhe bizneset private të Qytetit të Klinës dhe ishin te gatshej japin kontributin e tyre për familjet që jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Kështu u siguroi një fond simbolik i cili u shpenzua për blerjen e artikujve dhe mbushjen e pakove me dhurata për 8 familje.

Andaj, si përfundim, me 19 Dhjetor, vullnetarët e vet organizuar dhe të mbështetur nga ”Qendra Rinore Ardhmeria-Klinë” shkuan derë me derë për tu uruar familjeve në nevojë festat e fund vitit me nga dy pako dhuratë me gjëra ushqimore dhe higjienike të cilat u dhuruan nga vet të rinjtë.

Përmes kësaj Iniciative humanitare ”Qendra Rinore Ardhmeria Klinë” u angazhua të përgatis të rinjë me vlera humane dhe ngritje të ndjenjes për punë vullnetare për tu shërbyer të tjerëve në nevojë.

Falenderojmë të gjithë qytetarët dhe bizneset që kontribuan në këtë Iniciativë rinore.



Zhvilluar me 19 Dhjetor 2024

1.22 PERMBYLLJA E VITIT 2024



Me
eve
ntin
ton
ë
fina
l 🎉
Chr
ist
mas

party 🎉 përfunduar vitin 2024.

Vullnetaret kaluan një mbrëmje festive dhe shumë argëtuese, ku gjithashtu kanë reflektuar të gjitha aktivitetet e organizuara gjatë tërë vitit .

Vullnetaret janë Certifikuar për punën vullnetare gjatë tërë vitit 2024, gjithashtu ekipi i organizates është shumë mirënjohës për të gjithë ata që kontribuan në zhvillimim e aktiviteteve rinore në Klinë.



🎉 Gëzuar Krishtlindja dhe Vitin e ri 2025 🌲🎁🎉

1 BASHKËPUNIME DHE PARTNERËT

2.1 PARTNERSHIP –CHRISTEN FUR EVROPA-DRESDEN GERMANY

Organizata ICE partnere nga Gjermania ka përzgjedhur 1 vullnetar nga (Dugajeva) Klina .

1. FSJ, Adrian Gojani për të punuar si vullnetar e ne programin gjerman FSJ në Dresden në periudhë 12 mujore, projekti filloi në Gusht 2024 dhe perfundon ne Gusht 2025.

Projekti është i financuar nga fondi I vullnetareve gjerman me qellim që të zhvillohen aftësitë rinore dhe për të shkëmbyer kultura të ndryshme.



Zhvilluar prej 1 Shtator 2024- 30 Gusht 2025

2.2 PARTNERSHIP –EFEM AKDEINIZ GENCLIK DERNEGI- ANTALYA, TURKIYE

Organizata **EFEM AKDEINIZ** partnere nga Turqia ka përzgjedhur 1 vullnetare nga Prishtina.

1. ESC, Arbnora Millaku, vullnetare ne në periudhë 6 mujore dhe Qendra rinore eshte organizate derguese ne kete project.

Zhvilluar prej 1 Gusht-Dhjetor 2024

2.3 PARTNERSHIP – HUMAN

Në projektin “Fuqizimi i lidhjeve ndërmjet OSHC-ve dhe Institucioneve publike në promovimin e sundimit të ligjit në Kosovë” QRAK eshte partnere lokale dhe ka përgjegjësi për mobilizimin e vullnetarëve dhe vizitën e familjeve derë më derë, bisedën me familjarët dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve, duke rritur në këtë mënyrë ndërgjegjësimin e qytetarëve në zonat rurale për antikorrupsionin, sundimin e ligjit, etikën në qeveri dhe publik. arsimimi.

Zhvilluar prej Dhjetor 2023- Shtator 2024

2.4 BASHKEPUNIM – KORPUSI I PAQES.

Organizata amerikane Korpusi i paqes ka sjellur tek ne një vullnetar (Zach Bernkoph), për të punuar si vullnetar i korpusit të paqes në Klinë në periudhë prej 24 muajve. Aktiviteti ka filluar në Nëntor 2022 . Vullnetari vazhdoi te punoj në menaxhmentin e Qendres Rinore dhe ka mbeshtetur ekipin punues të projekteve deri në fund Tetorit 2024.

Zhvilluar nga Nëntor 2022-Tetor 2024.

2 PROJEKTET

3.1 PROJEKTI-NISMA PËR FUQIZIMIN E TË RINJEVE

Projekti është implementuar nga Qendra Rinore Ardhmeria-Klinë me përkrahjen e projekt i financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ne Kosovë. Projekti mundësoi realizimin e aktiviteteve dhe funksionimin e qendres rinore ne periudhen 6 mujore duke filluar nga

Nentori 2023 dhe perfundoj me 11 Maj 2024.



3.2 PROJEKTI-ZHVILLIMI I KAPACITETEVE RINORE

Projekti “Zhvillimi I kapaciteteve rinore” është organizuar nga Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë me përkrahjen e Subvencionit të Komunës së Klinës dhe gjëgjësisht Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport. Projekti mundësoi realizimin e aktiviteteve: Ligjerata për vetëdijësim dhe parandalimin e sëmundjeve infektuese , Ligjerata per vetëdijësimin e higjenës personale, Ëorkshop për zhvillim të aftësive të buta Fushatë motivuese për iniciativat rinore në komunitet.

Qershor-Dhjetor 2024

3 STATISTIKAT /PËRFITUESIT